DALJSE IZLAZNA-OUTGOING
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. 020-403/1
Data 17-06-2020

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova-Republic of Kosovo
### Qeveria - Vlada – Government

*Ministria e Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government*

| | | |
|---|---|---|
| Për: | **Abdülhadi Krasniç**, Kryetar i Komunës së Mamushës<br>**Buyar Mazrek,** Kryesues i Kuvendit të Komunës së Mamushës | |
| Kopje: | Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MPL<br>Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë | |
| Përmes: | **Goran Rakić**, Zëvendëskryeministër dhe Ministër në MPL<br>**Rozafa Ukimeraj**, Sekretare e Përgjithshme e MPL-së | |
| Nga: | **Venera Çerkini**, Udhëheqës e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave | Datë: 12.06.2020 Nr.020-403 |
| Zyrtaret përgjegjës:<br>1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor<br>2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor | **Xhevat Tafa**, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave<br>**Leonora Bajrami**, Zyrtare për Monitorim të Komunave | |
| Lënda: | Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Mamushës | |
| Lloji i aktit: | □ Vendim i Kuvendit të Komunës | |

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

| |
|---|
| Vendimi 01-Nr-03-20,për bashkëpunim ndërkomunal |
| I miratuar më datë: 28.02.2020 |
| I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 09.06.2020 |

Ministria e Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural **<u>është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi</u>** dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike. Ministria e Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejmë në lidhje me këtë vlerësim.

DALJE-IZLAZNA-OUTGOING
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 020-403/1
Date Datum Date 17.06.2020

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
*Ministria e Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government*

| | | |
|---|---|---|
| Za: | Abdulhadi Krasniç, gradonačelnik Opštine Mamuša<br>Buyar Mazrek, predsedavajući Skupštine opštine Mamuša | |
| Kopija: | Jedinici za administraciju dokumenata u MLS-u<br>Jedinici za administraciju dokumenata u opštini | |
| Preko: | Goran Rakić, zamenik premijera i ministar MLS-a,<br>Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka u MLS-u, | |
| Od: | Venera Çerkini, rukovodilac Pravnog odeljenja i monitorisanje opština, MLS | Dana, 12.06.2020.<br>Br.020-403 |
| Službenik-ca za utvrđivanje pravne procene:<br><br>Službenik-ca za izradu pravne procene: | Xhevat Tafa, rukovodilac Odseka za monitorisanje opština<br><br>Leonora Bajrami, službenica za monitorisanje opština | |
| Predmet: | Potvrda zakonitosti akta opštine Mamuša | |
| Vrsta akta: | Odluke Skupštine opštine | |

Poštovani gradonačelniče,
Poštovani predsedavajući,

U saglasnosti sa Uredbom Vlade Republike Kosova br.10/2019 o administrativnom razmatranju akata opštine i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i Uredbom Vlade br. 02/2011 o oblastima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Pravno odeljenjei monitorisanje opština MLS-a, primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

| |
|---|
| Odluka 01-br-03-20, o međuopštiskoj saradnji |
| Usvojena dana, 28.02.2020. godine |
| Predložena na razmatranje u MLS-u dana, 09.06.2020. godine |

Ministarstvo lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akata opštine, procenjuje da je **akt u saglasnosti sa zakonskim odrebama zakonodavstva na snazi** i kao takav može provesti pravni učinak.
Ministartsvo lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za dodatna objašnjenja u vezi sa ovim procenama.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Data 09.06.2020

| Njësia organizative | Nr. i Lëndës | Shtojca | Vlera |
| --- | --- | --- | --- |
| 01 | 020-493 | | |

**REPUBLIKA E KOSOVËS – KOSOVA CUMHURIYETI**

**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**

**MAMUŞA BELEDIYESI – KOMUNA E MAMUSHËS**

**OPŠTINA MAMUŠA – MUNICIPALITY OF MAMUSA**

01-Nr-03-20

Më date: 28.02.2020

Ne baze te neneve 12, 17 lidhur me nenin 28 dhe 29, të Ligjit Nr-03/L-040, për vetëqeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008", e në mbështetje të nenit 6, pika 2.1 lidhur me pikën 6, të Ligjit Nr 04/L-010 për bashkëpunim ndër-komunal, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-7/2011" dhe konform nenit 5, paragrafi 1, pika 1.1 lidhur me nenin 6, të Rregullores Nr. 09/2013 për nxitjen e bashkëpunimit ndër-komunal dhe neneve 17, 18, 44, pika 1 te Statutit te Komunës se Mamushës, në mbledhjen e mbajtur me datën, 28.02.2020, miraton këtë:

# VENDIM

## Neni 1

1.1 Miratohet nisma e Kryetarit të Komunës së Mamushës për të hyrë në bashkëpunim ndër-komunal me Komunat tjera të Republikës së Kosovës.

1.2 Bashkëpunimi ndër-komunal do të zhvillohet në mesë të Komunave tjera të Republikës së Kosovës si në vijim:

- **1.2.1** Komunës së Suharekës të Republikës së Kosovës
- **1.2.2** Komunës së Prizrenit të Republikës së Kosovës
- **1.2.3** Komunës së Dragashit të Republikës së Kosovës dhe
- **1.2.4** Komunës së Mamushes të Republikës së Kosovës

## Neni 2

**AUTORIZOHET**, Kryetari i Komunës që të fillon konsultimet dhe bisedimet për hartimin e marrëveshjes për bashkëpunim ndër-komunal në mesë të Komunës së Suharekës të Republikës së Kosovës, Komunës së Prizrenit të Republikës së Kosovës, Komunës së Dragashit të Republikës së Kosovës dhe Komunës së Mamushesë të Republikës së Kosovës dhe palët tjera të interesuare për bashkëpunim.

## Neni 3

**OBLIGOHET-** Kryetari i Komunës që pas përfundimit të konsultimeve dhe në bazë të konsultimeve paraprake të përgatisin draft-marrëveshjen për themelimin e bashkëpunimit ndër-komunal në mesë 4, (katër) Komunave dhe atë në kuadër të kompetencave të tyre vetanake, finacimin e "Qendrës për strehimin e grave dhe fëmijëve" dhe nenshkruhet nga Kryetaret e Komunave dhe miratohet nga Kuvendet Komunale të Komunave që janë pjesëmarrse në bashkëpunimin ndër-komunal.

## Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Mamushës, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dergimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale, Nr 03/L-040, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr- 28/2008") nenit 6, të Rregullores, Nr-01/2016, për shqyrtimin administrative te akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

**KUVENDI I KOMUNËS NË MAMUSHË**

Kryesuesi i Kuvendit

Buyar Mazrek

## Leonora Bajrami

| | |
|---|---|
| **From:** | Besa Shala |
| **Sent:** | Thursday, June 11, 2020 10:08 AM |
| **To:** | Leonora Bajrami; Blerta Halimi |
| **Cc:** | Trim Berisha |
| **Subject:** | RE: Aktet e KK Prizrendhe Mamushë |

Të nderuar/a,

Vendimet e Komunës së Prizrenit dhe Komunës së Dragashit janë në harmoni me Ligjin për bashkëpunim nderkomunal.

Me respect,
Besa Shala

**From:** Leonora Bajrami
**Sent:** 10 June 2020 15:57
**To:** Blerta Halimi; Besa Shala
**Cc:** Xhevat Tafa; Venera Çerkini; Trim Berisha
**Subject:** Aktet e KK Prizrendhe Mamushë

Pershendetje

Të nderuara po ju përcjellë Vendimet e kuvendit të komunës së Prizrenit dhe Mamushës, lidhur me Nismën e Kryetarit te Prizrenit për bashkëpunim me komunën e Suharekës ,Dragashit dhe Mamushës si dhe Nismën e Kryetarit të Mamushë për bashkëpunim me komunën e Prizrenit, Suharekës dhe Dragashit andaj kërkoj nga Divizioni juaj për bashkëpunim ndër komunal si divizion kompetent, që ta jepni mendimin se a është ne harmoni me legjislacionin ne fuqi dhe a i plotëson kushtet për ta konfirmuar ligjshmërinë

Pres përgjigjen në afat sa me te shpejtë që është e mundur ne mënyrë qe ta kthejmë përgjigjen në komunë brenda afatit.
Ju faleminderit për bashkëpunimin!

Me respekt
Leonora

## Leonora Bajrami

**From:** Leonora Bajrami
**Sent:** Friday, June 12, 2020 9:32 AM
**To:** Idriz Mazrek
**Cc:** Xhevat Tafa; Buyar.Mazrek
**Subject:** Vendim për bartje të mjeteve të pashpenzuara të të hyrave vetanake nga 2019 ne 2020

I nderuar,

Po ju shkruaj lidhur me vendimin 01-Nr-03-20 për bashkëpunim ndërkomunal ne mes te Komunave Suharek-Prizren-Dragash-Mamushe,per arsye se vendimi duhet te jete edhe ne gjuhen serbe nuk mund te kthejmë vlerësimin e ligjshmërisë se aktit.

Bazuar në Rregulloren (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, (shtojca II - Aktet e organeve të komunës që nuk i nënshtrohen shqyrtimit të detyrueshëm apo të rregullt të ligjshmërisë), Ministria e Pushtetit Lokal pas shqyrtimit të përmbajtjes së akteve të Komunës së Mamushës, si në vijim:

- Vendimi për bartjen e mjeteve të pa shpenzuara të të hyrave vetanake nga viti 2019 ne vitin 2020 vlerëson se akti i komunës (në aspektin procedural) është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike.

Ministria e Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejmë në lidhje me këtë vlerësim.

Me respekt
Leonora;